

Reforma Penale dhe Gjinia

PËRMBAJTJA

Pse gjinia është e rëndësishme për reformën penale?

Si mundet gjinia të integrohet në reformën penale?

Sfidat dhe mundësitë pas – konfliktit

Pyetjet rreth reformës penale

Më tepër informata

Egziston një vlerësim i fortë rreth asaj se Reforma Sektorit të Sigurimit (RSS) duhet të plotësojë nevojat e ndryshme të sigurisë për burrat, gratë, djemtë dhe vajzat. Integrimi i çështjeve të gjinisë gjithashtu paraqet çelsin drejt efektshmërisë dhe përgjegjësisë të sektorit të sigurimit, pronës lokale dhe ligjshmërisë të proceseve të RSS-it.

Ky Konspekt Praktik siguron një hyrje të shkurtër rreth dobive mbi integrimin e çështjeve të gjinisë në reformën e drejtësisë, gjithashtu edhe informata praktike se si të bëhet.

Ky Konspekt Praktik është bazuar në një procedurë më të gjatë, dhe të dyja janë pjesë të Gjinisë dhe Mjetit Praktik të RSS-it e dizajnuar për të siguruar një njohje rreth çështjeve të gjinisë për praktikuesit dhe krijuesit e dëftësave të RSS-it, Mjeti Praktik përfshin 12 Mjete përkatëse me Konspektin Praktik – shih në Më tepër informata

Pse gjinia është e rëndësishme për reformën penale?

Reforma penale është punë që bëhet për ta ndryshuar sistemin penal me qëllim që ta sjell në pajtim me rregullat ligjore dhe strukturën internacionale të të drejtave njerëzore. Ka për qëllim të sigurojë sanksione të cilat janë proporcionale, jo-diskriminuese dhe riabilituese, si dhe të ndryshon institucionet e burgut në vende të cilat do ta respektojnë dinjitetin njerëzor të individit, dhe të siguron që të burgosurit tu jepen të drejtat e tyre ligjore.¹

Gjinia i referohet roleve dhe marrëdhënieve, vecorive të personalitetit, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave që shoqëria ju atribuon burrave dhe grave. Pra “Gjinia” i referohet dallimeve të mësuara ndërmjet burrave dhe grave, përderisa “Seksi” i referohet dallimeve biologjike ndërmjet gjinisë mashkullore dhe femërore. Rolet e gjinisë ndryshojnë mjaft brenda dhe përmes kulturave, dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjinia nuk i referohet thjeshtë vetëm grave dhe burrave por gjithashtu edhe marrëdhënies ndërmjet tyre.

Standardet e të drejtave njerëzore

- Që institucionet penale ti plotësojnë standardet e të drejtave njerëzore internacionale dhe regjionale, kërkohet që të gjithë atyre të cilëve u është marrur liria me forcë të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe me respekt për dinjitetin përkatës për qenien njerëzore.
- Të pengohet dhe të reagohet ndaj dhunës seksuale në ambientet e burgut, duke përfshirë atë që kryhet nga personeli i burgut.

Dëftesa penale jo-diskriminuese

- Të sigurohet që dëftesat penale dhe procedurat të reflektohen dhe të drejtohen për nevojat e dukshme të femrave dhe meshkujve të burgosur, rinisë, fëmijëve dhe grupeve tjera të marginalizuara.

Rehabilitimi i të burgosurve

- Të sigurohet që iniciativat e rehabilitimit dhe reintegrimin tu drejtohen dhe tu përshtaten nevojave dhe kapaciteteve njëjloj si për femrat ashtu edhe për meshkujt e burgosur, si dhe realitetin e shoqërisë në të cilën jetojnë, duke mos rrezikuar univerzalitetin e standardeve të përkrahura për mirësjellje dhe dinjitet.

Shëndetësia publike

- Të jepet shëndetësi publike më e mirë duke i paraqitur sëmundjet të përhapura seksualisht midis të burgosurve të gjinisë mashkullore dhe femërore dhe duke siguruar shërbime shëndetësore reproduktive adekuate për femrat e burgosura, duke përfshirë ato që mund të jenë shtatëzënë.

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Reforma Penale Indiane dhe Shoqata e Drejtësisë (PRAJA) organizuan Kampe Shëndetësore një javore në dy burgje në Hyderabad dhe Rajahmundry, si pjesë e programit për të promovuar shëndetësinë mentale dhe kujdesin për gratë në burg. Kampet Shëndetësore bënë të arritshme këto lehtësime për të gjithë gratë dhe fëmijët në burg: informim të përgjithshëm dhe kontrollë, duke përfshirë tensionin e gjakut, krahërorin, lëkurën, gjatësinë/peshën/gjendjen shëndetësore; testim të gjakut; kontrollë dentale; kontrollim të syve/hundës/fytit; kontrollë gjinekologjike; jepnin këshilla për dietë dhe shëndetësore; përgjigjeshin për pyetjet rreth problemeve tjera fizike dhe psikike. Projektet e Kampeve Shëndetësore të PRAJAs demonstrojnë si, madje edhe në shtete mjaft të varfëra, mund të gjehen metodat për mundësinë e distribuimit që të drejtave themelore edhe në raste kur të dhënat janë mjaft të kufizuara.

Përkrahja e burrave dhe grave si punonjës në sektorin penal

- Promovim I pjesëmarrjes të plotë njëlloj si për gratë ashtu edhe për burrat si punonjës të sektorit penal.
- Pengim dhe reagim adekuat për shqetësimin seksual dhe diskriminimin kundër stafit të burgut.

Pajtueshmëria me obligimet sipas ligjeve dhe dokumentave ligjore internacionale

Marrja e iniciativës për ti shkruirë çështjet e gjinisë në reformën juridike nuk paraqet vetëm një çështje të efikasitetit operacional; gjithashtu është e nevojshme të jetë në pajtim me ligjet internacionale dhe regjionale, dokumentat ligjore dhe normat që i përkasin sigurimit dhe gjinisë. Dokumentat ligjore kryesore përfshijnë:

- Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave Diskriminuese Kundër Grave (CEDAW, 1979
- Rezoluta e Mbledhjes Gjenerale të Kombeve të Bashkuara 52 / 86 mbi Parandalimin e Krimit dhe Masat e Drejtësisë Penale për të Eliminuar Dhunën Kundër Grave (1998)

Për më tepër informata, ju lutem shihni Aneksin e Mjetit Praktik mbi Ligjet Internacionale dhe Regjionale dhe Dokumentat ligjore.

Si mundet gjinia të integrohet në reformën penale?

Vlerësimi

Kryerja e një vlerësimi gjinor të sistemit penal. Klasifikimi i të gjitha të dhënave (në minimum) për nga gjinia, moshja dhe kombësia. Vlerësimi duhet të vështron në:

- ✓ Legjislacioni i zbatueshëm
- ✓ Dëftesa dhe procedura penale njëlloj si për të burgosurit e gjinisë femërore ashtu edhe për gjininë mashkullore
- ✓ Një varg programe dhe shërbime të arritshme për burrat dhe gratë
- ✓ Mundësi për hyrjen në shërbimet shëndetësore
- ✓ Të dhëna në nivel të dhunës gjinore (GBV) nëpër burgjet
- ✓ Barazi ndërmjet meshkujve dhe femrave të personelit të burgut
- ✓ Rregulla të sjelljes në vend për të drejtuar sjelljen e stafit të burgut
- ✓ Prezenca e mekanizmave të ankesës dhe mbikëqyrjes për të vëzhguar pajtimin me dëftesat, procedurat dhe rregullat e sjelljes

Dëftesat dhe procedurat për përgjegjësinë gjinore

- Evaluimi i dëftesave dhe procedurave penale nga pikëpamja e gjinisë për të qenë të sigurtë që janë proporcionale, jo-diskriminuese dhe në drejtim me nevojat të ndryshme të burgosurve të gjinisë femërore dhe mashkullore. Në veçanti, të sigurohet që gratë të mos hasin diskriminim në arrestimin gjatë paraburgimit ose klasifikimit të sigurimit.
- Të sigurohet që të burgosurit e gjinisë mashkullore dhe femërore të burgosen afër familjeve të tyre, si dhe të parashihen dispozita të cilat do të ndihmonin kontaktet e rregullta me familjen

- Të sigurohet mundësi e hyrjes në kujdesin shëndetësor për meshkujt dhe femrat e burgosur (shih Shembullin 1), duke përfshirë edhe mundësinë për mjek të gjinisë femërore për femrat e burgosura dhe kujdes shëndetësor reproduktiv, si dhe shërbime të pavarura të shëndetësisë mentale.
- Të sigurohet që nevojat e shëndetësisë fizike dhe mentale për gratë shtatëzëne, lehonat dhe fëmijët duhet dhënë e siguruar.

Të parandalohet dhe të reagohet ndaj dhunës gjinore (GBV)

- Të themelohen rregulla të sjelljes sa i përket shqetësimeve seksuale, diskriminimit dhe dhunës gjinore (GBV) nga stafi i burgut, si dhe mekanizmat për denoncim të besuar.
- Të themelohet legjislacioni, protokolet dhe procedurat për tu ballafaquar me dhunën gjinore mes të burgosurve, duke përfshirë masa preventive dhe ndëshkuese, si dhe protokole për kujdes dhe referim të viktimave (shih Shembullin 2).
- Të sigurohet prezenca e personelit të duhur dhe të aftësuar për tu ballafaquar me çështjet sensitive gjinore si abuzimi seksual dhe format tjera të dhunës gjinore.
- Të krijohet kulturë me zero tolerancë sa i përket shqetësimeve seksuale, abuzimit dhe keqsjelljes nga personeli i burgut dhe të promovohet kulturë për respekt për të drejtat e të burgosurve, duke përfshirë të drejtën e përfitimit si vizitat bashkëshortore, pa marrë parasysh gjininë e tyre, orientimin seksual ose kombësinë.

Mekanizmat e mbikëqyrjes dhe ankimit

- Të themelohen mekanizma me nivel nacional të brendshëm dhe të jashtëm të mbikëqyrjes dhe trupa duke përfshirë sistemet e pavarura të inspektimit dhe raportim dhe dokumentacion të qartë:
 - Ekipet të inspektimit me inspektorë meshkuj dhe femra, si dhe inspektorë me ekspertizë mbi çështjet e gjinisë, me qëllim që të fitohet besimi i të gjithë të burgosurve dhe dretimi adekuat i problemeve si dhuna gjinore (GBV).
 - Të përfshihen specialistë shëndetësor në ekipin e inspektimit për ti vlerësuar pajisjet dhe procedurat e burgut.
- Të krijohen mekanizma të ankimit të brendshëm për përgjegjësinë gjinore:
 - Të sigurohet që procedurat e ankimit janë të arritshme, sa të jetë e mundshme e të besueshme, dhe ajo që të burgosurit të janë të mbrojtur nga masat ndëshkuese.
 - Rishikim i pavarur i ankimeve me qëllim që të mbrohen të burgosurit të gjinisë mashkullore dhe femërore nga abuzimet e të drejtave njerëzore, si dhe stafi i burgut nga akuzimet e rrejshme.
 - Të sigurohet që të burgosurit analfabet të jenë plotësisht në gjendje të kuptojnë dhe të kenë mundësinë e qasjes në mekanizmat e ankimeve.

Shembulli 2 Eliminim i përdhunimit në burg

Në Shtetet e Bashkuara, Stop Përdhunimit në Burg, një Organizatë Jo Qeveritare është duke bërë fushatë me vite të tëra kundër këtij abuzimi. Në vitin 2003, Akti për Eliminimin e Përdhunimit në Burg u bashkangjit në ligj. Ligji apelon në mbledhjen e statistikave nacionale mbi përdhunimin në burgjet e SHB, zhvillimi i direktivave për shtetet se si të ballafaqohen me përdhunimin e burgut, themelimi i një paneli për rishikim që të mbajë seancë për shqyrtime vjetore si dhe dhënja e ndihmës financiare shteteve që të luftojnë këtë problem. Një evaluim i tre viteve të para që nga momenti kur Akti u bë ligj tregon përparim të konsiderueshëm në çështjen e zvogëlimit të përdhunimit në burg nëpërmjet:

- Krijimi i dëftesave (më mirë se fshehtësia dhe mohimi)
- Parandalim (nëpërmjet më shumë vendeve të konsideruara të të burgosurve, më pak të mbushura dhe arsimim i të burgosurit)
- Hetim dhe ndjekje penale
- Shërbime për viktimat
- Stërviçja e stafit
- Bashkëpunim me agjensitë jashtë- burgut

Stërviçja gjinore

Të sigurohet stërviçja gjinore për të gjithë personelin e burgut, duke i përfshirë temat si:

- Të drejtat njerëzore të të burgosurve dhe trajtimi i duhur i burrave, grave, djemve dhe vajzave në burg
- Parandalim dhe reagim i duhur për dhunën gjinore, duke e përfshirë edhe përdhunimin e meshkujve.
- Shëndetësi dhe higjienë për të burgosurat, duke i përfshirë pajisjet e sendeve si letrat higjienike dhe pajisje të duhura të toaletit.
- Nevojat e veçanta të grupeve të prekshme të të burgosurve, si gratë shtatëzëne dhe nënat e fëmijëve të cilët gjithashtu jetojnë në burg.
- Nevojat e të burgosurave para-lirimit dhe gjatë lirimit, duke përfshirë strehimin e sigurt, ndihmë për ribashkimin familjar dhe stërviçje profesionale.

Të rritet pjesëmarrja e grave dhe organizatave të shoqërisë civile

- Të rritet punësimi, ruajtja dhe përparimi i personelit të femrave në burg.
- Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, të sigurohen shërbime për femrat e burgosura si këshillim profesional dhe të besueshëm (shih Shembullin 3).
- Të angazhohet shoqëria civile, veçanërisht organizatat e grave, në proceset e reformës penale:
 - Të krijohet përkrahje publike për reformën penale, të punohet me parlamentin, shoqërinë civile dhe mediumet.

- Të bashkëpunohet me organizatat e shoqërisë civile për të rritur vetëdijen dhe të ndërtohet kapaciteti i brendshëm mbi shqetësimet gjinore në sistemin penal.
- Të ndërtohet kapaciteti i organizatave të shoqërisë civile për të vëzhguar sistemin penal nga pikëpamja e gjinisë.

Gjithashtu në dispozicion në Mjetin 5 ...

- Shembuj dhe këshilla për inspektionin e përgjegjësishë gjinore dhe procedurat e ankimit
- Konsiderime për përmirësimin e rregullimeve për vizitat në burg
- Ruajtja e dinjitetit njerëzor në sistemin penal
- Protokol me 12 hapa për reagim dhe hetim të deklaratave për përdhunim
- Tu ndihmohet grave shtatëzëne dhe nënave të reja

Sfidat dhe mundësitë pas – konfliktit

Në kontekstet pas-konfliktit, rindërtimi i sistemit penal shpesh shihet si prioritet i dobët në krahasim me nevojat tjera rikonstruksionuese. Brenda këtij konteksti, rrjedha e përgjithshme e çështjeve gjinore në reformën penale shpesh pranon vëmendje dhe përkrahje jo adekuate. Prandaj është e rëndësishme që të sigurohet që institucioni shtetëror administrativ e kupton qartë nevojën për qendrat gjinore-përgjegjëse për parburgim.

Sfidat për integrimin e çështjeve të gjinisë

- Burgjet mund të kenë një imazh shumë të keq në mes popullatës si rezultat i arrestimit pa gjykim, përdhunimit, torturës dhe ekzekutimit.
- Sistemi i mëparshëm i burgut mund të ketë qenë jo funksional, principet e rregullit të ligjit mund të mos kenë qenë të aplikuar dhe barazia gjinore mund të ketë qenë një koncept i panjohur. Burgu gjithashtu mund të ketë qenë i drejtuar nga policia ose ushtria, e kundërt me praktikën e mirë të të drejtave njerëzore.

Mundësitë për integrimin e çështjeve të gjinisë

- Rindërtimi mund që të jetë një mundësi për të përkrahur themelimin e një sistemi i cili do të jetë më pak abuziv, më me përgjegjësi gjinore dhe më i besueshëm nga njerëzit.
- Ambienti pas-konfliktit mund të siguron një mundësi për të drejtuar një census dhe një process identifikimi të atyre personave në sistemin e listës së pagave të burgut e ndjekur nga një proces verifikimi për të identifikuar stafin që supozohet të janë autorë të krimit për shkelje të mëdha të të drejtave njerëzore.

Shembulli 3 Angazhimi i shoqërisë civile

Në Jemen, Komiteti Nacional i Grave promovon dialog me vendimtarët për të siguruar drejtësi për gratë. Deri kohëve të fundit, gratë e burgosura të cilat kishin kryer dënimin e tyre e kishin të ndaluar të largohen nga burgu nëse nuk i mirrte kujdestar mashkull. Komiteti Nacional i Grave kreu presion në Ministrinë për Punë të Brendshme dhe rregullore u ndryshua. Unioni i Grave të Jemenit ka 36 avokatë vullnetarë të cilët japin ndihmë ligjore falas për gratë e varfëra në burgjet, gjyqet dhe stacionet e policisë. Si rezultat i ndihmës të tyre ligjore, 450 femra të burgosura u liruan në vitin 2004 dhe 2005.²



Pyetjet rreth reformës penale

Një nga mënyrat më të mira për të identifikuar pikat hyrëse, përforcimet dhe mangësitë për inkorporimin e perspektivave gjinore në reformën penale është të sillt një vlerësim. Më poshtë janë disa pyetje mbi gjininë të cilat janë të rëndësishme të përfshihen në vlerësimin, vëzhgimin dhe proceset e evaluimit në reformën penale.

- A janë ligjet, dëftesat dhe procedurat e përgjegjësishë gjinore në vend të duhur që në mënyrë adekuate të përballojnë çështjet si përdhunimi në burg?
- A egzistojnë trupat e vëzhgimit dhe të mbikëqyrjes të jashtme të pavarur për të vëzhguar me efikasitet shqetësimet seksuale, diskriminimin, përdhunimin dhe format e dhunës gjinore?
- A mundet proceset e mbajtjes të të dhënave të mundësojnë të sillen përfundimet për trajtimin e grupeve të ndryshme? A janë statistikave të ndara për nga gjinia, mosha dhe kombësia? A janë këto informata të arritshme për publikun, mediën dhe trupat mbikëqyrës qeveritar?
- A kanë femrat dhe meshkujt e burgosur mundësi hyrje adekuate në shërbimet e shëndetësishë? Çfarë furnizime janë të arritshme për shëndetin fizik dhe mental të grave shtatzëne, lehonat dhe fëmijët?

- Si është siguruar kontakti familjar për burrat dhe gratë në arrestim?
- A implementon sistemi i burgut iniciativa të vecanta për të ndaluar dhe reaguar mbi dhunën gjinore, si sigurim të shërbimeve për viktimat e dhunës gjinore?
- A ka pranuar personeli i burgut stërvitje mbi çështjet e gjinisë, duke e përfshirë stërvitjen specifike mbi shqetësimet seksuale, përdhunimit dhe format tjera të dhunës seksuale?
- A janë gratë dhe burat proporcionalisht të përfaqësuar midis personelit të burgut? A janë gratë në poste të mbikëqyrjes dhe të drejtimit? A janë marrë iniciativa për të rritur punësimin, ruajtjen dhe përparimin e stafit femëror?
- A është shoqëria civile e përfshirë në vlerësimin e burgut, në krijimin e dëftesave, në vëzhgim dhe në aktivitetet mbikëqyrëse?

Më tepër informata

Burimet

Bastick, M. – *Gratë në Burg: Një Koment mbi Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve, Zyra e Kombeve të Bashkuara Quaker*, 2005.

OECD - DAC - *OECD DAC Manual mbi Reformën e Sistemit të Sigurimit: Përkrahje Sigurimit dhe Drejtësisë*, 2007.

ICRC – *'Pjesa e II Gratë të Deprivuara nga Liria e tyre' Duke ju Drejtuar Nevojave të Grave Të Ndikuara nga Konflikti I Armëve*, 2004.

Qendra Internacionale për Studimet e Burgut – *Shënime Drejtuese mbi Reformën e Burgut*, 2005.

Qendra Internacionale për Studimet e Burgut – *Një Kahje e të Drejtave Njerëzore për Drejtimin e Burgut*, 2002

Instituti Urban – *Duke ju Drejtuar Dhunës Seksuale Në Burgjet: Një Pamje Nacionale e Çastit mbi Drejtimet dhe Pjesëve Kryesore të Raportit Final të Strategjive Inovative*, 2006.

Organizatat

Qendra Internacionale për Studimet e Burgut – www.prisonstudies.org
Reforma Penale dhe Shoqata e Drejtësisë (Indi) – www.prajaindia.org/prajainaction.html

Reforma Penale Internacionale – www.penalreform.org
Këshilli I Quaker për Çështjet Europiane, Gratë në Burg – www.quaker.org/qcea/index.html

[org/qcea/index.html](http://www.qcea/index.html)

Stop Përdhunimit të Burgut – www.spr.org

Shoqata e Burgut të Grave – www.wpaonline.org

Gjinia dhe Mjeti Praktik i RSS-it

1. Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 2. Reforma Policore dhe Gjinia
 3. Reforma Mbrojtëse dhe Gjinia
 4. Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia
 5. Reforma Penale dhe Gjinia
 6. Drejtuesit e Kufirit dhe Gjinia
 7. Mbikëqyrje Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 8. Sigurimi Nacional I Krijimit të Dëftesës dhe Gjinia
 9. Mbikëqyrje e Shoqërisë Civile mbi Sektorin e Sigurimit dhe Gjinia
 10. Ushtria Private dhe Kompanitë e Sigurimit dhe Gjinia
 11. Vlerësimi I SSR, Vëzhgim dhe Evaluim dhe Gjinia
 12. Stërvitje Gjinore për Personelin e Sektorit të Sigurimit
- Прилог за меѓународните и регионалните закони и инструменти

Secila nga këto Mjete dhe Konspekte Praktike janë në dispozicion në: www.dcaf.ch www.un-instraw.org dhe www.osce.org/odih.

Ky Konspekt Praktik u përgadit nga Ana Korneeva nga UNINSTRAW, e bazuar mbi Mjetin 5 e shkruar nga Qendra Internacionale për Studimet e Burgut

¹ Coyle, A., A Kahje e të Drejtave Njerëzore për Drejtimin e Burgut: Manual për Stafin e Burgut, (Qendra Internacionale për Studimet e Burgut: Londër), 2002.

² Oxfam, 'Programi I Mbikëqyrjes të Jemenit'. http://www.oxfam.org.uk/what_we_work/yemen/programme.htm